



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate



RAPORT MONITORIMI I REKOMANDIMEVE 2025

www.investment.com.al



RAPORT MONITORIMI I REKOMANDIMEVE

2025

Këshilli i Investimeve është një platformë e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me synim intensifikimin e dialogut mes qeverisë dhe sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit dhe promovimin e mirë qeverisjes. Platforma mbështetet nga një sekretariat i përbërë prej një grupi të pavarur profesionistësh të zgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për tu angazhuar drejtpërdrejtë me komunitetin e biznesit. Financimi aktual për Sekretariatit e KI, sigurohet nga Sekretariati Shtetëror Zvicëran për Çështjet Ekonomike (SECO).

Materiali është përgatitur nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, znj. Xaira Shurdha, Eksperte e Ndërlidhjes dhe Monitorimit nën udhëheqjen e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni) me mbështetjen e z. Elvis Zerva, Ekspert Ligjor e Rregullator dhe znj. Elida Fara, Eksperte Ekonomie. Materiali është redaktuar nga znj. Elisa Lula, Specialiste e Komunikimit pranë Sekretariatit, duke ofruar mbështetje edhe në përgatitjen e dizajnit.

Informacioni i përmbledhur në këtë raport është përpiluar bazuar në aktivitetet monitoruese, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e BERZH-it apo SECO-s. Materiali (tekst apo imazh), nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të specifikuar në të.

Tiranë, Janar 2026



PËRMBAJTJA

01	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	06-08
02	DINAMIKA E REKOMANDIMEVE	09-23
	2.1 Pasqyrë e rekomandimeve 2015-2025	09
	2.2 Avokimi për përmbushjen e rekomandimeve	11
	2.3 Ecuria e rekomandimeve gjatë 2025	13
03	SHTOJCA 1 - METODOLOGJIA E MONITORIMIT	24-26
04	SHTOJCA 2 - LISTA E DOKUMENTAVE TË KONSULTUARA	27-29

SHKURTIME

AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor Rural
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KI	Këshilli i Investimeve
KM	Këshilli i Ministrave
KPI	Tregues kryesor i performancës
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
NMVM	Ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme
SECO	Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështje Ekonomike
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në një dekadë, Këshilli i Investimeve (KI) ka funksionuar si një hapësirë e strukturuar bashkëpunimi mes institucioneve publike dhe përfaqësuesve të biznesit, duke synuar nxitjen e transparencës, forcimin e besimit dhe nxitjen e një qasjeje të bazuar në evidencë në hartimin e politikave, si dhe në orientimin e reformave drejt çështjeve konkrete të biznesit.

Janë hartuar 29 dokumente analitike që mbulojnë 15 fusha, duke shërbyer si bazë teknike për formulimin e 357 rekomandimeve të miratuara në Këshill si dhe janë shqyrtuar mbi 120 ligje e 28 strategji veçanërisht në fushat e të drejtës dhe regjistrimit të pronës, kuadrit të inspektimeve, procedurave administrative, planifikimit territorial, si dhe në përmirësimin gradual të shërbimeve publike e proceseve të digjitalizuara. Në disa raste, këto kontribute janë reflektuar në ligje dhe akte nënligjore të miratuara ose të rishikuara, ndërsa në raste të tjera kanë ndikuar në qartësimin e praktikave administrative dhe orientimin e reformave në vazhdim. Megjithëse ritmi i zbatimit të rekomandimeve ka qenë i ndryshëm ndërmjet sektorëve dhe reformave, progresi i arritur me rreth 50% e këtyre rekomandimeve të zbatuara në një masë 50-100%, dëshmon se KI ka kaluar nga një forum konsultimi në një mekanizëm funksional reformues. Në të njëjtën kohë, ky progres evidenton sfida të vazhdueshme në koordinimin ndër-institucional dhe në kapacitetet zbatuese të institucioneve publike.

Gjatë përvojës dhjetëvjeçare është ndërtuar një bazë e qëndrueshme ekspertize përmes angazhimit të mbi 30 ekspertëve në punë kërkimore dhe analitike, si dhe janë forcuar lidhjet me akademinë përmes tre memorandumeve bashkëpunimi me universitete publike dhe private duke përfshirë mbi 25 studentë në procese studimore dhe analitike.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i funksionimit dhjetëvjeçar të KI lidhet me transparencën. Gjatë kësaj periudhe, Sekretariati i KI ka ndërtuar një praktikë të

rregullt raportimi dhe informimi publik përmes publikimit të raporteve vjetore dhe të monitorimit, fletëinformueseve, përmbledhjeve të indikatorëve makro-ekonomikë dhe dokumenteve analitike mbi zhvillimet rregullatore dhe institucionale, duke krijuar një bazë të qëndrueshme informacioni për aktorët publikë dhe privatë. Këto produkte kanë kontribuar në rritjen e transparencës mbi ecurinë e reformave dhe në dokumentimin sistematik të progresit dhe sfidave në zbatim. Paralelisht, sekretariati i KI ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), përmes angazhimit në aktivitete të nivelit të lartë të BE-së dhe rajonit, që kanë shërbyer për të përforcuar shkëmbimin e informacionit dhe për të pozicionuar çështjet e klimës së biznesit në diskutime më të gjera reformuese, duke reflektuar një rol teknik dhe mbështetës të Këshillit në proceset e përafrimit me standardet evropiane.

Referuar vitit 2025, zbatimi i rekomandimeve të KI karakterizohet nga një kombinim zhvillimesh si në nivel rregullator ashtu dhe strategjik. Ndonëse një vit elektorale, u miratuan disa strategji sektoriale në fusha të tilla si turizmi, eksportet, statistikat zyrtare, arsimit digjital e siguria kibernetike, që reflektojnë harmonizim me prioritetet e integritimit evropian dhe me agjendën e reformave strukturore. Shumica e këtyre dokumenteve mbeten ende në fazën e planifikimit dhe krijimit të kornizës rregullatore, ndërsa efektet e zbatimit në rritjen e produktivitetit, përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe forcimin e klimës së investimeve pritjet të materializohen në vijim.

Nga analiza rezultojnë se gjatë vitit 2025 janë shënuar zhvillime të rëndësishme në disa drejtime:

1. *Aksesi në financë për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të), me krijimin e instrumenteve të reja financiare, si nga partneritete strategjike me institucione ndërkombëtare dhe me institucione brenda vendit. Ndërkohë, ka nisur puna për Taksonominë e Gjelbër Kombëtare, duke reflektuar koherencë me rekomandimet të KI-së.*
Më specifikisht, iniciativa ka pasur në mbështetjen e sektorit bujqësor, ku skema e garancisë sovraane dhe përpjekjet për ngritjen e skemave të sigurimeve bujqësore përfaqësojnë masa konkrete drejt adresimit të riskut dhe mungesës së kolateralit, dy pengesa strukturore të identifikuar prej vitesh nga KI. Disbursimi i kredive nën skemën e re të Bankës së Shqipërisë dhe orientimi drejt investimeve afatgjata përbëjnë sinjale pozitive, por niveli ende relativisht i ulët i përthithjes dhe alokimi i një vlere të ulët për produktet e dedikuara për gratë sipërmarrëse, tregojnë se përfshirja financiare mbetet e pjesshme dhe kërkon ndërhyrje më të targetuara.
2. *Forcimi i ekosistemit të inovacionit dhe transformimi digjital i NMVM-ve kanë avancuar përmes zhvillimeve në drejtim të krijimit të “Qendrave Evropiane të Inovacionit Digjital” dhe integritimit të tyre në rrjetin e BE-së, duke sinjalizuar qasje më strukturore ndaj adoptimit teknologjik. Megjithatë, këto mekanizma janë ende në fazë operacionalizimi dhe kërkojnë konsolidim institucional dhe financiar për të prodhuar efekte të qëndrueshme në nivel sektorial dhe territorial.*
3. *Formalizimi i ekonomisë ka shënuar zhvillime pozitive si në nivel strategjik ashtu dhe operacional. Miratimi i Strategjisë Afat-Mesme të të Ardhurave dhe krijimi i programeve për zgjerimin e pagesave elektronike reflektojnë një qasje*

më të balancuar midis mbledhjes së të ardhurave, rritjes së produktivitetit dhe formalizimit. Rritja e përdorimit të POS-eve dhe numrit të ATM-ve gjatë vitit 2025 përbën një tregues konkret të ndikimit të këtyre politikave, veçanërisht në sektorët e shërbimeve dhe turizmit. Megjithatë, qëndrueshmëria e këtyre masave do të varet nga ulja reale e kostove për bizneset e vogla dhe nga koordinimi më i fortë ndërmjet institucioneve fiskale, financiare dhe vendore.

4. *Mbështetja e eksporteve dhe ndërkombëtarizimi i bizneseve shqiptare:* Miratimi i “Programit për nxitjen dhe lehtësimin e eksporteve 2026–2030” shënon një kalim nga ndërhyrjet fragmentare drejt një kornize më të strukturuar politike, e përafruar me proceset rajonale dhe standardet e BE-së. Megjithatë, sfida të tilla si modernizimi i laboratorëve të testimit dhe funksionaliteti i plotë i platformave mbështetëse për eksportet kërkojnë vëmendje të mëtejshme për të siguruar ndikim të qëndrueshëm në kohë.
5. *Problematikat e pronësisë:* Vlerësohet pozitivisht miratimi i “Udhërrëfyesit të Digjitalizimit të Sistemit Kadastral 2025–2028” duke vendosur bazat për një transformim institucional, përmirësim të transparencës dhe aksesit në shërbime, si dhe forcim të sigurisë juridike. Automatizimi i një pjese të shërbimeve dhe përparimi në digjitalizimin e të dhënave përfaqësojnë masa konkrete pozitive, por ende larg objektivit për krijimin e një Kadastrë Digjitale transparente dhe në funksion të mbështetjes së investimeve private.

DINAMIKA E REKOMANDIMEVE

2.1 PASQYRË E REKOMANDIMEVE 2015-2025

Që nga nisja e veprimtarisë së tij, KI ka zhvilluar tridhjetë e gjashtë mbledhje, gjatë të cilave janë trajtuar çështje specifike që lidhen me problematikat e të bërit biznes në vend, të identifikuara dhe të prioritetuara përmes votimit të agjendës. Anëtarët e KI kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në këtë proces, duke sugjeruar tematika e vlerësuar temat e propozuara, si dhe duke ndarë komente dhe pikëpamje për evidentimin e sfidave kryesore të biznesit.

Nga totali i rekomandimeve të dhëna në mbledhje, rreth 13% janë propozuar drejtpërdrejt nga anëtarët e KI-së përmes ndërveprimit në mbledhjet plenare, ndërsa rreth 87% janë mbështetur në analizat paraprake të Sekretariatit në konsultim me subjekte apo ekspertë të fushës për çështje më specifike. Ky proces bazohet në një qasje të strukturuar, e cila përfshin shqyrtimin e raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare, konsultime me përfaqësues dhe ekspertë të sektorit privat, koordinimin e grupeve të punës në bashkëpunim me institucione qeveritare dhe aktorë të tjerë relevantë, analizën e të dhënave të mbledhura përmes anketave, si dhe integrimin e kontributeve nga diskutimet teknike dhe fokus-grupet mbi gjetjet paraprake, përpara paraqitjes së tyre në mbledhjet plenare.

Rekomandimet e miratuara në KI, synojnë ndërhyrje në pesë nivele: (i) Strategjike, (ii) Institucionale, (iii) Ligjore, (iv) Transparencë dhe Ndërgjegjësim, dhe (v) Politika. Një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve (40%) ka vënë theksin mbi stabilizimin dhe qëndrueshmërinë e institucioneve, promovimin e një qasjeje të koordinuar, forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional, rritjen e kapaciteteve, përmirësimin e standardit dhe cilësisë së shërbimeve. Në tërësinë e tyre, këto rekomandime pasqyrojnë një


kërkesë të vazhdueshme për forcimin e kornizës institucionale, me synim zbatimin e mirëkoordinuar, efikas dhe operacionalisht të qëndrueshëm të strategjive, politikave dhe legjislationit.

Më specifikisht, rreth 25% e totalit të rekomandimeve fokusohet në ndërhyrje ligjore, duke përfshirë ndryshime në 53 ligje dhe akte ligjore, duke theksuar angazhimin e KI në reformat ligjore. Ndërkohë, 21% e rekomandimeve propozojnë ndërhyrje në nivel strategjik për çështje që lidhen me informalitetin, pronësinë, zhvillimin e aftësive të forcës së punës, aksesin në financë, investimet publike dhe strategjike, eksportet, sektorët prioritarë dhe fusha të tjera kyçe.

Në aspektin sektorial, 60% e rekomandimeve të periudhës 2015–2025¹ kanë adresuar ndërhyrje që ndikojnë të gjithë sektorët e biznesit, ndërsa 40% e tyre janë fokusuar në sektorët prioritarë për zhvillimin ekonomik, si në Turizëm (7%), Bujqësi (7%), Energji (6%), Ndërtim (5%) dhe Agro-përpunim (5%). Këto rekomandime propozojnë një qasje strategjike të orientuar në nxitjen e formalizimit dhe krijimin e kuadrit ligjor mbështetës, të qëndrueshëm dhe të thjeshtë për bizneset.

Gjatë dhjetë viteve të funksionimit të KI-së janë dhënë gjithsej 357 rekomandime, të cilat pasqyrojnë një nivel mesatar progresi. Nga këto, 29,1% janë zbatuar plotësisht dhe 21,6% janë realizuar pjesërisht (rreth 50–70%) dhe 31,9% e rekomandimeve rezultojnë ende të pazbatuara, çka sinjalizon ekzistencën e pengesave strukturore, institucionale apo operative që vijnë në ndikojnë negativisht në realizimin e tyre. Ndërkohë, 17,4% janë në fazë zbatimi, duke dëshmuar përpjekje graduale, por pa arritur ende rezultate të plota dhe përfundimtare.

Tabelë 1. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të KI, Dhjetor 2025



1 60% e totalit prej 357 rekomandimesh.

2.2 AVOKIMI PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE

Përveç ndjekjes periodike të ecurisë së rekomandimeve të KI dhe komunikimit të vazhdueshëm me institucionet zbatuese, Sekretariati është angazhuar në mënyrë aktive edhe në ofrimin e inputeve dhe kontributeve teknike, me synim mbështetjen e përmbushjes së rekomandimeve dhe përmirësimin e procesit të politikëbërjes për klimën e investimeve:

- *Kontribut në procesin e vlerësimit periodik të “Indeksit të Politikave të NVM-ve² për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, i koordinuar nga OSCE, OECD dhe partnerë ndërkombëtarë.* Në këtë kuadër, Sekretariati i KI-së ka ofruar inpute analitike dhe referenca konkrete në seksionet që lidhen me ndikimin e politikave kombëtare të inovacionit mbi produktivitetin e NVM-ve, duke kontribuar veçanërisht në dokumentimin e studimeve dhe vlerësimeve të realizuara mbi inovacionin, produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e bizneseve.

Përmes përfshirjes së analizave, raporteve teknike dhe dokumenteve të prodhuara nga KI ndër vite, është evidentuar jo vetëm ekzistenca e një baze analitike mbi këto çështje, por edhe identifikimi i pengesave strukturore që kufizojnë efektivitetin e politikave të inovacionit. Po ashtu, Sekretariati ka reflektuar mënyrën se si gjetjet dhe rekomandimet e diskutuara në tryezat e KI-së janë përdorur si referencë për rregullime të kuadrit strategjik dhe për ndërhyrje të reja politike.

- *Kontribut në “Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025”:* Në përgjigje të kërkesës për inpute mbi Kapitullin 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale”, Sekretariati ka ofruar inpute të strukturuar dhe referenca analitike të bazuara në punën shumëvjeçare të KI-së. Këto inpute janë marrë parasysh në vlerësimin e Kapitullit 20 në raportin final të progresit, veçanërisht në pasqyrimin e zhvillimeve lidhur me rishikimin e Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve (BIDS), avancimin e kuadrit të specializimit inteligjent, forcimin e instrumenteve për ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve), si dhe evidentimin e sfidave të vazhdueshme që lidhen me zbatimin e politikave, cilësinë e konsultimit publik dhe nevojën për koordinim më efektiv ndërinstitucional.
- *Në kuadër të hartimit të “Raportit të Rezultateve të Mekanizmit të Pavarur të Raportimit (IRM) për Shqipërinë 2023–2025”³,* Sekretariati i KI ka kontribuar me komente të argumentuara mbi dimensionin e dialogut publik–privat dhe funksionimin e proceseve të konsultimit publik, veçanërisht në kuadër të Angazhimit 23. Kontributi i Sekretariatit është fokusuar në evidentimin e rritjes së interesit të sektorit privat për t’u përfshirë në forma të strukturuar dialogu me administratën publike, fakt që reflektohet edhe në rritjen e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të biznesit në mbledhjet e Këshillit të Investimeve. Njëkohësisht, janë theksuar kufizimet ekzistuese që lidhen me natyrën e konsultimeve, mungesën e analizës cilësore mbi mënyrën se si trajtohen

2 SME Policy Index

3 Partneriteti për Qeverisje të Hapur : Independent Reporting Mechanism Results Report Albania, 2023-2025

komentet e marra, si dhe me kapacitetet e pamjaftueshme të shoqatave të biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile (veçanërisht atyre jashtë Tiranës) për të ofruar kontribute në kohë dhe me përmbajtje të thelluar. Sekretariati ka adresuar gjithashtu praktikën e ndërveprimeve informale jashtë kornizave zyrtare të dialogut, duke theksuar nevojën për rritjen e transparencës, institucionalizimin e mekanizmave të konsultimit dhe garantimin e një përfshirjeje më të gjerë dhe më të barabartë të aktorëve. Këto komente janë reflektuar në përmbajtjen përfundimtare të raportit, duke kontribuar në një pasqyrim më të plotë dhe më realist të sfidave dhe progresit në fushën e pjesëmarrjes dhe qeverisjes së hapur në Shqipëri.

- **Forcimi i kapaciteteve të dhomave të tregtisë dhe shoqatave të biznesit:** Në ndjekje të rekomandimeve të KI-së, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO) kanë ofruar asistencë teknike të dedikuar, e strukturuar në dy komponentë kryesorë: rritjen e kapaciteteve avokuese të këtyre aktorëve dhe zhvillimin e kapaciteteve të brendshme trajnuese për ndërkombëtarizimin e NVM-ve.

Deri më tani, në kuadër të komponentit të parë, janë realizuar intervista dhe anketa me 20 shoqata biznesi dhe dhoma tregtie, është përgatitur Raporti i Vlerësimit të Nevojave, si dhe janë zhvilluar dy nga tre sesionet e planifikuara të workshopit të parë mbi teknikat e avokimit të politikave, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga tetë dhoma tregtie dhe shoqata biznesi. Në vijim të projektit parashikohet:

- përmbyllja e sesionit të tretë të këtij workshopi;
- zhvillimi i dy serive të workshop-eve mbi navigimin e politikave;
- hartimi i paketave të komunikimit për shoqatat e biznesit;
- zhvillimi i dy moduleve trajnuese me materialet përkatëse;
- organizimi i një sesioni “Trajnim për trajnerët” me fokus ndërkombëtarizimin e NVM-ve.

Këto aktivitete synojnë rritjen e qëndrueshmërisë dhe efektivitetit të rolit të këtyre institucioneve në dialogun publik-privat dhe proceset reformuese.

- **Mbështetje e Autoritetit të Konkurrencës:** Përmes asistencës teknike nga EBRD, që prej shtatorit 2023, është mbështetur Autoriteti i Konkurrencës me fokus përafrimin e legjislacionit kombëtar me standardet e BE-së në kuadër të Kapitullit 8 dhe forcimin e kapaciteteve zbatuese. Progresi kryesor përfshin hartimin e ndryshimeve ligjore, transpozimin e direktivave të BE-së dhe zhvillimin e trajnimeve të synuara për gjyqësorin në bashkëpunim me UNCTAD, duke krijuar bazat për një kulturë më të konsoliduar të konkurrencës në Shqipëri.
- **Përgatitja dhe publikimi i përmbledhjes:** “Kuatru i Ri i Inspektimit në Shqipëri: Një Udhëzues Ligjor dhe Rregullator Për Bizneset” e mbështetur në ligjin nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Reforma synon unifikimin dhe modernizimin e sistemit të inspektimeve, me fokus uljen e barrës administrative për bizneset, rritjen e transparencës dhe forcimin

e besueshmërisë së institucioneve publike. KI ka luajtur një rol kyç në evidentimin e problematikave të mëparshme, si kostot e larta administrative, vendimmarrja e pakoordinuar e inspektoriateve dhe mungesa e efektivitetit të procesit të ankimimit. Konsultimet me bizneset nxorën në pah nevojën për një reformë të thellë që të reduktojë kontrollet e panevojshme dhe të përmirësojë klimën e biznesit. Megjithatë, suksesi i reformës varet nga zbatimi i saj praktik, funksionimi i sistemeve digjitale dhe respektimi i mekanizmave mbrojtës kundër abuzimit. Përmbledhja ofron informacion të strukturuar mbi rregullat, institucionet përgjegjëse dhe të drejtat e detyrimet e tyre ndaj bizneseve, me qëllim rritjen e përputhshmërisë ligjore. KI do të vijojë monitorimin për të siguruar rezultate konkrete për bizneset dhe klimën e investimeve.

2.3 ECURIA E REKOMANDIMEVE GJATË 2025

Bazuar në një proces të vazhdueshëm ndjekjeje dhe komunikimesh formale e informale me institucionet publike, evidentojmë se 24 rekomandime janë marrë në konsideratë prej tyre gjatë vitit 2025, duke rezultuar në një nivel të moderuar përmbushjeje duke qenë se 15 nga këto rekomandime janë konsideruar të zbatuara në masën 70-100%, ndërsa 9 të tjera janë në fazën fillestare të zbatimit. Institucionet publike të kontaktuara gjatë procesit të monitorimit kanë shfaqur gatishmëri për të ofruar informacion mbi përditësimin e rekomandimeve. Megjithatë, përgjigjet e marra kanë qenë të përgjithshme dhe shpesh ka munguar ofrimi i shifrave konkrete apo ndikimeve të matshme.

Referuar dinamikave ligjore që ndikuan në ecurinë e 10 rekomandimeve këtë vit, evidentojmë kryesisht:

- » VKM nr. 733, datë 3.12.2025 “Për miratimin e planit të veprimit të Agjendës Digjitale për Arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale”
- » Urdhër i Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 180, datë 30.12.2025 “Programi për nxitjen dhe lehtësimin e eksporteve 2026–2030”
- » Urdhër i Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 183, datë 30.12.2025 “Për miratimin e planit të veprimit për promovimin e eksporteve dhe ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve, përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë përmes korridor-eve të gjelbra”
- » “Strategjia për sigurinë kibernetike 2025–2030 dhe plani i veprimit 2025–2027” miratuar me VKM 606, datë 23.10.2025.
- » “Strategjia e Turizmit 2025–2030 dhe të planit të veprimit” aprovuar me VKM Nr. 466, datë 31.7.2025
- » VKM 463 dt. 31.07.2025 “Miratimi i skemës së veçantë të garancisë shtetërore të huasë për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë”
- » Ligji nr. 50/2025 “Për ratifikimin e vendimit nr. 2/2024, të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore për Tregtinë Elektronike”, aprovuar në 3.7.2025 që ratifikon vendimin e CEFTA-s për lehtësimin e tregtisë elektronike.

- » Vendim nr. 260, datë 7.5.2025 “Për shpalljen e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik dhe zhvilluesit të zonës me vendndodhje në Xhafzotaj, Shijak”.
- » VKM Nr. 99, datë 12.2.2025 “Për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit dhe detyrat e komitetit për të dhënat statistikore në turizëm”
- » Vendim nr. 77, datë 5.2.2025 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore” - data-baza e treguesve të statistikave zyrtare.
- » VKM 73 dt. 29.01.2025 “Për miratimin e planit të zhvillimit të detajuar dhe draftmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe zhvilluesit, Korporata e Investimeve Shqiptare, për angazhimet e ndërsjella për ndërtimin, administrimin, menaxhimin, funksionimin, operimin dhe monitorimin e parkut teknologjik dhe shkencor DURANA TECH PARK”
- » Për konsultim publik projektligji “Për Identifikimin Elektronik, Shërbimet e Besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital” më 3 Qershor 2025 (vijnë konsultimet gjatë periudhës Qershor - Dhjetor 2025 me palë të interesit).

Nga monitorimi ynë, rezulton se zhvillimet më të dukshme janë përqendruar në shtyllat e mëposhtme:

Angazhim për përmirësimin e Aksesit në Financë për NMVM-të në Shqipëri – Skema të Reja dhe Partneritete Strategjike

Në vite, KI ka evidentuar aksesin në financë si një nga tre problematikat kryesore që hasin NMVM-të shqiptare. Tre nga rekomandimet e KI-së, kanë theksuar nevojën për diversifikimin e instrumenteve tradicionale të financimit, përdorimin më efikas të skemave të garancisë, adoptimin e teknologjive të informacionit në menaxhimin e riskut dhe zhvillimin e mekanizmave inovativë të ndarjes së riskut, përfshirë fonde të dedikuara shtetërore dhe publike-private, si dhe produkte financiare të përshtatura për sektorë prioritarë, bujqësinë, nismat digjitale dhe gratë sipërmarrëse.

- » Referuar këtyre rekomandimeve dhe në vijim të mbledhjes së fundit të KI në 2024 “Për përmirësimin e instrumenteve të financimit - Perceptime dhe sugjerime nga komuniteti i biznesit dhe sektori financiar”, që nga shkurti i 2025 Banka e Shqipërisë prezantoi një skemë të re financimi⁴ në vlerën prej 25 miliardë lekësh, e dedikuar për mbështetjen e NMVM-ve që operojnë kryesisht në sektorin e bujqësisë, agroturizmit, etj. Skema synonte lehtësimin e aksesit në financë për këto biznese përmes kushteve të favorshme kreditimi, me norma të reduktuara interesi që variojnë nga 2% për kreditë e mbuluara me garanci sovraane deri në maksimumi 3.5% për ato të bazuara në analizat e riskut të bankave të nivelit të dytë. Kreditë ofrohen në lekë dhe ekskluzivisht për investime, duke përkrahur kështu zhvillimin afatgjatë të bizneseve. Skema është aktualisht në fazë zbatimi përmes bankave tregtare dhe deri në fund të dhjetorit janë disbursuar 127 kredi me vlerë totale 1.7 miliard lekë.⁵
- » Gjithashtu, janë ndërmarrë disa marrëveshje për forcimin e aksesit në financë për

4 https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Konferenca_per_shtyp/Pyetje_ pergjigjet_e_konferences_per_shtyp_te_dates_5_shkurt_2025.html
5 Banka e Shqipërisë, Janar 2026

NMVM-të, me mbështetje nga institucione ndërkombëtare. Union Bank ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me BERZH-in dhe BE-në⁶ për krijimin e një fondi të dedikuar për digjitalizimin e bizneseve të vogla dhe të mesme përmes dy programeve: (1) “Bëhu digjital” që do të mbështesë digjitalizimin dhe modernizimin e tyre, si dhe do të nxisë investimet e gjelbra, (2) “Të rinjtë në biznes” që synon të rrisë qasjen në financë për bizneset e vogla në pronësi ose të drejtuara nga sipërmarrës të rinj, duke synuar rritjen e kapaciteteve teknologjike dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë së tyre. Në të njëjtën kohë, ProCredit Bank ka konsoliduar partneritetin me BERZH-in⁷ për të ofruar financim të qëndrueshëm për NMVM-të në kuadër të “Programit të Rinisjes së Qëndrueshme për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në Ballkanin Perëndimor”⁸ dhe “Bëhu digjital”,⁹ iniciativa që promovojnë investime të gjelbra, inovacion, efikasitet energjetike dhe zhvillim të qëndrueshëm për bizneset në Shqipëri.

- » Në janar 2025, Banka e Shqipërisë dhe Banka Evropiane e Investimeve (BEI) nënshkruan një marrëveshje strategjike për zhvillimin e financave të gjelbra në vend, e cila parashikon hartimin e një Taksonomie të Gjelbër¹⁰ për klasifikimin e aktiviteteve të qëndrueshme, mbështetje për bankat në mobilizimin e fondeve për projekte të gjelbra, ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e rreziqeve klimatike si dhe përgatitjen për përafrim me standardet e BE-së në këtë fushë. Deri në fund të dhjetorit 2025, janë zhvilluar takime të rregullta pune me ekipin e ekspertëve, duke avancuar zhvillimin e Taksonomisë së Gjelbër Kombëtare dhe analizën e boshllëqeve të financave të gjelbra në raport me kuadrin rregullator të BE-së (EU Taxonomy, SFDR, CRR/CRD). Paralelisht, është ngritur një grup pune ndërinstitucional që ka dakordësuar parimet dhe strukturën e qeverisjes së taksonomisë, ndërsa në takimin e dytë të nivelit të lartë, të planifikuar në janar 2026, pritet miratimi i modelit përfundimtar të qeverisjes dhe përcaktimi i hapave vijues drejt finalizimit të draftit të parë, të parashikuar për fillimin e vitit 2027.

Megjithatë, vihet re një mungesë vëmendje sa i takon produkteve financiare të dedikuara për gratë në biznes. Përveç paketës së financimit dhe asistencës teknike prej 1 milion euro, nënshkruar në nëntor 2025 mes BERZH dhe Procredit Bank për zbatimin e skemës “Gratë në biznes”,¹¹ ky aspekt nuk evidentohet as në skemën e re të Bankës së Shqipërisë dhe as në marrëveshje të tjera në sektorin bankar, duke kërkuar fokus të shtuar në përputhje me rekomandimet për përfshirje financiare gjinore.

Referuar rekomandimit të KI-së, mbi forcimin e kapaciteteve të NVM-ve përmes edukimit financiar, duke promovuar programe praktike, interaktive dhe online, certifikime si dhe partneritete me shoqatat e biznesit dhe platforma të dedikuara për rritjen e aksesueshmërisë, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë, rezulton se përtej

6 <https://www.unionbank.al/lajmet-e-fundit/union-bank-marreveshje-me-berzh-dhe-be-per-te-ofruar-fonde-ne-mbeshtetje-te-bizneseve-te-vogla-shqiptare/>

7 https://www.linkedin.com/posts/procreditbank-albania_sustainable-reboot-programme-activity-7316020865899356160-pxrX?utm_source=share&utm_medium=member_desktop&rcm=ACoAABNpZmgBc-r06hZ9zjPELmQZFyBjQvIWebc

8 Sustainable Reboot Programme for SMEs in the WB

9 Go Digital

10 https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet_per_shtyp/Banka_e_Shqiperise_dhe_Banka_Evropiane_e_Investimeve_forcojne_bashkepunimin_per_financat_e_gjelbra.html

11 https://www.linkedin.com/posts/procreditbank-albania_n%C3%AB-procredit-bank-albania-jemi-t%C3%AB-p%C3%ABrkushtuar-activity-7395127657241165826-2-0V?utm_source=share&utm_medium=member_desktop&rcm=ACoAABNpZmgBc-r06hZ9zjPELmQZFyBjQvIWebc

aktiviteteve të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë¹² në zbatim të strategjisë për edukimin dhe përfshirjen financiare (2024–2026), disa banka tregtare kanë ndërmarrë iniciativa individuale në promovimin e njohurive financiare dhe mbështetjen për sipërmarrjen.¹³ Më konkretisht, Union Bank ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve mbi menaxhimin e rreziqeve financiare përmes leksioneve të hapura, si dhe ka bashkëpunuar me BERZH-in dhe BE-në për të mbështetur digjitalizimin dhe sipërmarrjen e të rinjve përmes një programi financimi prej 5 milionë euro. Po ashtu, ProCredit Bank ka përfshirë edukimin financiar si pjesë e panairëve kombëtare dhe ka ndarë njohuri praktike për gratë në punë në kuadër të Javës Globale të Parasë. Këto ndërhyrje tregojnë për një përpjekje të sistemit bankar jo vetëm për të avancuar edukimin financiar por edhe për rritje formalizimi. Megjithatë, mungesa e një platforme të përbashkët dhe gjithëpërfshirëse edukuese kombëtare kufizon shkallën e ndikimit dhe kohezionin e këtyre përpjekjeve.

Përpjekje për Formalizimin e Ekonomisë dhe Mbështetjen e NMVM-ve

- » Në mbledhjen e Kl-së “Sfidat e sektorit privat: administrata fiskale, produktiviteti dhe inovacioni”¹⁴, është dhënë rekomandimi mbi miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për mbledhjen e të ardhurave, e konsultuar paraprakisht me publikun, që përcakton qartë objektivat dhe ndërhyrjet afatmesme, forcon monitorimin dhe llogaridhënien, si dhe synon jo vetëm rritjen e të ardhurave, por edhe produktivitetin dhe konkurrueshmërinë, në përputhje me strategjitë sektoriale, Programin e Reformave Ekonomike 2024–2026 dhe Planin e Rritjes.

Për më tepër, Sekretariati i Kl-së gjatë vitit 2024 propozoi që në këtë strategji të përfshiheshin edhe 12 rekomandime nga mbledhjet e mëparshme.

Në përmbushje të rekomandimit, “Strategjia Afat-Mesme e të Ardhurave 2024–2027 dhe Plani i Veprimtimit 2024–2027” u miratua përmes VKM nr. 847 në 26 dhjetor 2024, dhe 10 nga rekomandimet e propozuara nga Kl u përfshinë në planin për zbatim të viteve në vijim. Kjo strategji është e rëndësishme për formalizimin e sektorit privat, pasi synon përmirësimin e mbledhjes së taksave dhe forcimin e administrimit fiskal. Strategjia është hartuar në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare dhe krijon bazën për kushte më të qarta dhe më transparente për funksionimin e bizneseve, duke nxitur regjistrimin dhe deklarimin e plotë të veprimtarive të tyre. Megjithatë, për impaktin e saj dhe disa objektiva më afatgjatë që lidhen me rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, do të nevojitet një vlerësim më i detajuar pas zbatimit më tej në praktikë.

- » Dy rekomandime, lidhur me nxitjen e formalizimit dhe inovacionit në sipërmarrje përmes inkurajimit dhe zgjerimit të përdorimit të pagesave elektronike, janë dhënë në dy mbledhje të Kl. Përmes këtyre rekomandimeve, theksohet nevoja për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe infrastrukturës së pagesave, uljen e kostove të aksesit bankar, rritjen e përdorimit të kartave dhe terminaleve POS, si dhe zbatimin

efektiv të rregullave të kategorizimit në sektorin e turizmit, me qëllim uljen e informalitetit, rritjen e transparencës fiskale dhe forcimin e konkurrueshmërisë dhe reputacionit të ofertës turistike shqiptare.

Në zbatim të këtyre rekomandimeve, në mars 2025 Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit¹⁵ dhe kompaninë ndërkombëtare Mastercard, prezantuan Programin Kombëtar për Përshejtimin e Pagesave Elektronike¹⁶ (POSI), me fokus të drejtpërdrejtë në formalizimin e sektorit privat. Programi synonte zgjerimin masiv të përdorimit të pajisjeve POS në të gjithë vendin, duke ofruar për biznese të përzgjedhura një periudhë përdorimi 12-mujore pa komision. Duke pasur në fokus biznese të vogla si ato të akomodimit, restoranteve dhe shërbimeve të transportit, kjo nismë përshejton kalimin drejt transaksioneve elektronike, duke kufizuar përdorimin e parasë fizike dhe duke forcuar gjurmueshmërinë ekonomike.

Programi vazhdon të zbatohet, por deri në fund të shtatorit 2025, siç raportohet nga Banka e Shqipërisë, numri i pajisjeve POS është rritur me rreth 20% krahasuar me 2024, duke arritur mbi 29 mijë terminale POS të instaluar në të gjithë vendin dhe numri i ATM-ve është rritur me 32% me 326 paisje të reja të instaluar.

Ndërhyrje për mbështetjen e financimit, sigurimit dhe eksportit në sektorin bujqësor

- » Referuar rekomandimit të Kl mbi nevojën për rritjen e nivelit të shfrytëzimit të skemave të garancisë së kredisë dhe domosdoshmërisë së rishikimit të kostove dhe procedurave administrative për të kontribuar në përmirësimin e aksesit të bizneseve në financim:

Në fillim të vitit 2025, u prezantua skema e garancisë sovrane për bujqësinë,¹⁷ si një instrument praktik për të përmirësuar aksesin në financë për fermerët dhe agrobizneset. Skema ofron norma interesi të subvencionuara nga 2% deri në 3.5% dhe mbulim deri në 70% të shumës së kredisë pa kolateral përmes fondit të garancisë së shtetit. Programi synon të nxisë investimet në zonat rurale, të rrisë nivelin e formalizimit dhe të përmirësojë kapacitetin konkurrues të sektorëve të përfshirë. Sipas Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), interesi i treguar nga fermerët është i lartë, duke reflektuar nevojën reale për mjete financimi të përshtatshme dhe të përbalueshme për zhvillimin bujqësor, por akoma nuk janë publikuar të dhëna mbi nivelin e përhithjes së këtyre fondeve.

- » Në lidhje me rekomandimin mbi krijimin e një mjedisi mundësues për rritjen e eksporteve shqiptare, përmes njohjes reciproke të certifikatave fitosanitare në rajon, modernizimit të laboratorëve të testimit, forcimit të promovimit ndërkombëtar dhe aktivizimit të diplomacisë ekonomike për “Made in Albania”.

Është miratuar me Urdhër të Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 180, datë

12 https://www.bankofalbania.org/Muzeu_dhe_Edukimi/Edukimi/Programet_educuese_te_Bankes_se_Shqiperise/
13 <https://aab.al/wp-content/uploads/2025/05/CSR-AAB-Janar-Mars-2025-Rev-3.pdf>
14 Mbledhje e Kl, 26 mars 2024

15 Aktualisht Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
16 <https://aab.al/prezantohet-posi-nje-hap-i-ri-drejt-digjitalizimit-te-pagesave-ne-shqiperi/>
17 https://azhbr.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/2740-dt.4.8.2025-Vendim-nr.463-dt.31.7.2025-Kryeministria-2-23.pdf?fbclid=IwY2xjawPbZbFleHRuA2FibQlxMABicmIKETfRk1YQ0EzbnhGNzFaMFhqc3JOYwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODlwMDg5MgABHTGBejFxfcaecatAsKaVgqVu-OsV0-KpftAi-dKfcaFEL4PUTBfDipmBAq0S9_aem_dZoPnUq52yCf4Cy2Q7KqNQ

30.12.2025, "Programi për nxitjen dhe lehtësimin e eksporteve 2026–2030", i cili përfshin një plan veprimi të detajuar që adreson drejtpërdrejt shtyllat kryesore të rekomandimit, përfshirë bashkëpunimin rajonal në kuadër të CEFTA/SPS, panairët ndërkombëtare, diplomacinë ekonomike dhe përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse për eksportet.

Programi parashikon masa konkrete për promovimin e eksporteve dhe markës "Made in Albania", duke përfshirë: fushata marketingu digjital, mbështetje financiare për pjesëmarrjen në panairë ndërkombëtare, organizimin e takimeve B2B dhe integrimin e promovimit të eksporteve në agjendën e diplomacisë ekonomike. Paralelisht, masat lidhen me Planin e Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM 2.0), duke synuar reduktimin e barrierave jo-tarifore, njohjen e certifikatave dhe rezultateve laboratorike në kufi, si dhe lehtësimin e tregtisë rajonale. Megjithëse dokumenti nuk paraqet një plan veprimi të dedikuar vetëm për laboratorët e testimit në formë kapitulli më vete, modernizimi i kapaciteteve të certifikimit dhe vlerësimit të konformitetit trajtohet si pjesë integrale e paketës së masave për lehtësimin e tregtisë dhe përputhshmërinë me standardet e BE-së, veçanërisht për sektorët agro-ushqimorë.

- » Në mbështetje të rekomandimit të KI për krijimin e skemave të sigurimeve në bujqësi duke prezantuar shtetin si ndërmjetës, janë marrë masa konkrete, përmes bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Në dhjetor 2024, Shqipëria nisi bashkëpunimin me Qeverinë Turke për ndarjen e përvojës dhe ngritjen e skemave të mbulimit për produktet bujqësore. Ky bashkëpunim u konkretizua në mars 2025 me nënshkrimin e Planit të Veprimit për Zhvillimin e Sigurimeve në Bujqësi, i cili përfshin zgjerimin e partneriteteve, shkëmbimin e ekspertizës, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe mbështetjen financiare për fermerët.

Krahas zhvillimeve institucionale, ka pasur një intensifikim të kërkimeve akademike¹⁸ që analizojnë gatishmërinë e fermerëve për të paguar për sigurimin bujqësor dhe vlerësimin e riskut në këtë sektor. Studime të realizuara nga akademikë shqiptarë dhe ndërkombëtarë, si në kuadër të projektit READ të financuar nga AADF, kanë ndihmuar në krijimin e një baze teknike për hartimin e skemave të sigurimit. Megjithëse iniciativat nuk janë tërësisht të udhëhequra nga qeveria, krijimi i kësaj baze analitike dhe rritja e ndërgjegjësimit mund të konsiderohen një progres i pjesshëm në këtë drejtim.

- » Në përputhje me rekomandimin për ngritjen e një Portali Sektorial të Eksportit, është vlerësuar si një hap pozitiv krijimi i platformës Export Albania,¹⁹ zhvilluar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe GIZ. Kjo platformë synon të mbështesë ndërkombëtarizimin e NMVM-ve shqiptare përmes ofrimit të informacionit mbi tregjet e huaja, përgatitjes për pjesëmarrje në panairë ndërkombëtare, asistencës teknike, udhëzuesve për eksport dhe mundësisë për rrjetëzim me kompani të huaja përmes lidhjes me platformën ndërkombëtare Kompass.

¹⁸ "Analiza e Rrezikut dhe Vlerësimi i skemave të Sigurimit Bujqësor në Shqipëri". 2025. https://www.researchgate.net/publication/389396202_Risk_Analysis_and_Premium_Assessment_in_Albanian_Agricultural_Insurance

Zhllima, Edvin, dhe Harri, Ardian. "Vlerësimi i Gatishmërisë së Fermerëve për të Paguar Sigurimin Bujqësor në Shqipëri". 2025.

"Ndërgjegjësimi dhe Qasja e Fermerëve ndaj Sigurimit Bujqësor si një Strategji për Zbutjen e Rrezikut" <https://www.ejbm.org/index.php/ejbm/article/view/2469>

¹⁹ www.exportalbania.al

Platforma përfshin komponentë të rëndësishëm si procedura doganore, raporte analitike të përzgjedhura mbi tendencat e tregut, një kalendar me evente dhe panairë për informimin e bizneseve, si dhe mundësinë për të ndërtuar profile prezantuese të kompanive. Ndërkohë janë zhvilluar edhe guida eksporti për pesë shtete partnere dhe një mjet vetëvlerësimi për gatishmërinë për eksport.

AIDA ka organizuar gjatë muajit qershor, "Info Day" dhe "Takime door to door" me bizneset ekportuese të qarqeve, Shkodër, Gjirokastër, Elbasan, Durrës, Berat (faza e parë), ku kanë bërë promovimin e platformës dhe sensibilizimin e kompanive eksportuese shqiptare për të përfituar nga shërbimet që ofron kjo platformë. Në platformën B2B, janë regjistruar 155 kompani eksportuese të sektorëve të ndryshëm. Gjatë vitit 2026 do vijojë faza e dytë me informimin dhe regjistrimin e bizneseve. Megjithatë, mungesa e përditësimit të rregullt dhe e thelluar e disa moduleve kufizon funksionalitetin e plotë të platformës si një mjet dinamik dhe gjithëpërfshirës për bizneset eksportuese shqiptare.

- » Në kuadër të mbështetjes për forcimin e kapaciteteve të bizneseve shqiptare dhe rritjen e pranisë së produkteve "Made in Albania" në tregjet ndërkombëtare, AIDA ka organizuar gjatë vitit 2025 disa aktivitete trajnuese në bashkëpunim me Damiani & Partners dhe GIZ Albania. Në shkurt 2025 u zhvillua një program trajnimi tre-ditor mbi kërkimin dhe analizën e tregut, gatishmërinë për eksport dhe B2B matchmaking, me pjesëmarrjen e kompanive nga sektorët e ushqimit, bimëve medicinale dhe aromatike, veshjeve, lëkurë-këpucëve dhe përpunimit të drurit. Një trajnim i dytë mbi "Gatishmërinë për eksport" u organizua në korrik 2025, duke përfshirë kompani nga agropërpunimi, pijet dhe ushqimi, si dhe sektori i drurit, me fokus përgatitjen për hyrje në tregje ndërkombëtare.

Paralelisht, AIDA ka mbështetur integrimin e sipërmarrjeve shqiptare në zinxhirët ndërkombëtarë të vlerës, veçanërisht në sektorët prioritarë të specializimit inteligjent (S3), përmes fondeve dhe programeve të dedikuara. Gjatë vitit 2025, Fondi për Zhvillimin e NVMV-ve, me një vlerë totale prej 131.83 milionë lekësh, mbështeti 85 subjekte nga 443 aplikime, kryesisht për digjitalizim, rritje të konkurrueshmërisë dhe zhvillim të ekonomisë kreative. Në të njëjtën kohë, projektet e financuara nga BE, përfshirë Enterprise Europe Network (EEN), mbështetën 268 kompani shqiptare gjatë vitit 2025, ndërsa iniciativa "Aftësi për Punësim të Qëndrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse në Rajonin Ndërkufitar Shqipëri-Mal i Zi – Aftësi për Punë" mbështeti 50 kompani gjatë periudhës 2023–2025. Këto aktivitete kontribuan në forcimin e kapaciteteve të inovacionit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe integrimin të NVMV-ve në zinxhirët globalë të vlerës.

Modernizimi dhe Digjitalizimi i Regjistrimit të Pronës

Referuar rekomandimit të KI mbi ndërtimin e një vizioni të konsoliduar dhe bashkëkohor për regjistrimin e pronës, të orientuar drejt prioritetëve të investimeve private, të shoqëruar me një plan veprimi të qartë për konsolidimin dhe digjitalizimin e regjistrimit të pronave, si dhe me masa për reduktimin e praktikave korruptive në administrimin e pronësisë.

- » Në qershor 2025, Agjencia Shtetërore e Kadastrës miratoi Udhërrëfyesin e Digji-

talizimit 2025–2028,²⁰ i cili u miratua gjithashtu nga Komiteti Ndërmator për Reformën e Menaxhimit të Integruar të Tokës dhe u prezantua në kuadër të programit të BE-së “EU for Property Rights”. Dokumenti përcakton vizionin, objektivat dhe hapat konkretë për transformimin digjital të sistemit kadastral, në përputhje me standardet e BE-së, duke adresuar drejtpërdrejt komponentin e planifikimit dhe operacionalizimit të reformës së pronësisë. Udhërrëfyeni parashikon objektiva të matshëm për skanimin dhe digjitalizimin e dokumenteve, kartelave të pronësisë dhe hartave kadastrale, si dhe për përfundimin e regjistrimit fillestar të zonave kadastrale deri në vitin 2028. Paralelisht, pritet finalizimi i një marrëveshjeje kontributi e cila do të mbështesë digjitalizimin e hartave të mbetura në letër, regjistrimet fillestare dhe rishikimin e të dhënave në zona të përzgjedhura, duke kontribuar në rritjen e transparencës, sigurisë juridike dhe përmirësimin e klimës së investimeve.

- » Në dhjetor 2025, Agjencia Shtetërore e Kadastrës raportoi se 10 shërbime kadastrale janë të automatizuara dhe ofrohen online përmes platformës qeveritare e-Albania për të dhënat të cilat tashmë e kanë kaluar procesin e digjitalizimit. Aktualisht është përfunduar skanimi i dokumentacioni të pronësisë dhe deri në qershor 2026 përfundon edhe digjitalizimi i kartelave të pasurisë (përfunduar rreth 80%). Paralelisht, rreth 10–15% e aplikimeve përpunohen në mënyrë të automatizuar dhe në kohë reale. Gjithashtu referohet se pagesat për shërbimet kadastrale kryhen online përmes platformës e-Albania, duke mundësuar konfirmimin e menjëhershëm të pagesës në sistemin e kadastrës dhe eliminimin e vonësive administrative që lidhen me verifikimin manual të pagesave.
- » Në lidhje me rekomandimin për krijimin e një “linje të shpejtë” të dedikuar për aplikantët biznes nga sektori financiar, vlerësohet se një zgjidhje është dhënë përmes shërbimit “FAST”, i cili mundëson trajtimin e aplikimeve për dokumenta pronësie brenda afateve më të shkurtra kohore (brenda 24 orëve nga konfirmimi i pagesës) krahasuar me procedurat standarde.
- » Sa i përket rekomandimit mbi hartimin e një liste prioritare të regjistrimit të pronës shtetërore dhe përshpejtimin e përfundimit të procesit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) informon se janë përcaktuar fillimisht 30 prona prioritare për çdo fashë dhe janë përfunduar dy fashat e para prioritare duke u regjistruar afërsisht 800 pasuri. Aktualisht janë përzgjedhur pronat e fashës së tretë, të cilat do t'i nënshtrohen procesit të përditësimit dhe regjistrimit në regjistrin kadastral. Gjithashtu për të nxitur procesin, reduktuar barrën financiare për bashkitë dhe eliminimin e pengesave ekonomike që mund të ndikojnë në vonesat e procesit të regjistrimit, ASHK ka vendosur tarifa të reduktuara për shërbimet kadastrale për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, duke aplikuar një tarifë simbolike prej 100 lekësh për regjistrimin e pronës dhe vetëm 10% të tarifës standarde të shërbimit.

Forcimi gradual i ekosistemit të inovacionit dhe mbështetja e transformimit digjital të bizneseve

20 <https://www.ashk.gov.al/2025/07/04/udherrefyeni-i-digjitalizimit-te-agjencise-shteterore-te-kadastres-2025-2028/>

Në funksion të nxitjes së inovacionit dhe digjitalizimit të NMVM-ve, janë dhënë dy rekomandime në KI mbi forcimin e bashkëpunimit qeveri–biznes–partnerë ndërkombëtarë për financimin e investimeve në sektorin TIK dhe konsolidimin e mbështetjes për teknologjinë dhe inovacionin përmes granteve dhe skemave të subvencionimit.

- » Gjatë vitit 2025 filloi puna për krijimin e Qendrave për Inovacionin Digjital (Albanian European Digital Innovation Hubs), përmes Njësisë së Inovacionit Digjital pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit. Kjo nënkupton një mekanizëm të ri mbështetës për ndërmarrjet, i orientuar drejt rritjes së produktivitetit, përmirësimit të proceseve dhe adoptimit të teknologjive të avancuara. Zbatimi i instrumentit të vlerësimit të pjekurisë digjitale për një numër të konsiderueshëm NVM-sh dhe institucioneve publike, si dhe ndërtimi i një qasjeje “testimi para investimit”, sinjalizon kalimin nga ndërhyrje të fragmentuara drejt ndërtimit të kapaciteteve strukturore. Pesë qendra janë krijuar dhe janë tashmë pjesë e Rrjetit Evropian të Qendrave për Inovacionin Digjital (EDIH),²¹ duke u integruar në platformën zyrtare të BE-së dhe duke ofruar shërbime të drejtpërdrejta për digjitalizimin e NMVM-ve, si dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat, akademisë dhe institucioneve publike. Paralelisht, përmes Programit READ²² të mbështetur nga Fondi Shqiptaro–Amerikan për Zhvillim (AADF), është nxitur angazhimi i diasporës akademike në projekte të kërkimit dhe inovacionit, duke krijuar ura bashkëpunimi që sjellin në vend ekspertizë ndërkombëtare, dije të përparuara dhe praktika të mira në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të NMVM-ve.

Megjithatë, këto zhvillime ndodhen ende në fazë operacionalizimi dhe kërkojnë konsolidim të mëtejshëm për të prodhuar efekte të matshme në nivel sektorial dhe territorial.

- » Gjatë fundit të vitit 2024 dhe në fillim të vitit 2025, disa nisma financiare janë ndërmarrë për financimin e NMVM-ve në drejtim të inovacionit.

Programi/Agjencia	Periudha e fillimit	Vlerat e Financimit
Agjencia Startup Albania – Programi i Financimit 2025	Dhjetor 2024	Deri në 100% të kostove në varësi të kategorizimit të biznesit
AIDA & MEI – Mbështetje për Zhvillimin e Biznesit	Shkurt 2025	Deri në 2.5 milion ALL (€25,000)
Fondi i Sfidës së Inovacionit – Faza 2	Prill 2024 në vijim	
Projekti “BE për Inovacionin” (EU4I)	Shkurt 2025	
BERZH & BE – “Bëhu Digjital në Ballkanin Perëndimor”	Prill 2025	€377 milion (Program rajonal)

21 <https://european-digital-innovation-hubs.ec.europa.eu/edih-catalogue?f%5B0%5D=country%3AAAlbania>

22 <https://www.aadf.org/project/read-research-expertise-from-the-academic-diaspora/>

- » Në drejtim të arsimit digjital, janë hedhur bazat ligjore dhe programore për integrimin sistematik të aftësive digjitale në sistemin arsimor. Miratimi i VKM nr. 733, datë 3.12.2025, për Planin e Veprimit të Agjendës Digjitale për Arsimin 2025–2030, përcakton një kornizë për transformimin digjital të arsimit në përputhje me standardet e BE-së. Dokumenti adreson zhvillimin e kompetencave digjitale, integrimin e teknologjisë në kurrikula, përmirësimin e infrastrukturës digjitale dhe rritjen e kapaciteteve të mësuesve përmes trajnimeve dhe certifikimeve të standardizuara. Në këtë fazë, ndërhyrjet janë kryesisht të orientuara drejt planifikimit dhe krijimit të standardeve, ndërsa ndikimi i tyre në cilësinë e arsimit dhe përputhshmërinë me nevojat e tregut të punës do të varet nga zbatimi i qëndrueshëm dhe mekanizmat e monitorimit të parashikuara në plan.
- » Në drejtim të sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave, miratimi i Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030, me VKM nr. 606, datë 23.10.2025, krijon bazën rregullatore dhe institucionale për forcimin e besueshmërisë së sistemeve digjitale. Strategjia adreson mbrojtjen e infrastrukturës kritike, menaxhimin e rreziqeve dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale, duke mbështetur zhvillimin e shërbimeve publike digjitale në nivel qendror dhe vendor. Megjithëse dokumenti nuk trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë aspektet mjedisore të përdorimit të teknologjive digjitale, ai vendos themelet për një qasje më të koordinuar ndaj sigurisë dhe integritetit të proceseve elektronike.

Aktivizimi i Zonave të Lira Ekonomike (TEDA) si nxitës i investimeve dhe zhvillimit teknologjik

Në lidhje me tre rekomandime të KI që konvergjojnë në *nevojën për aktivizimin dhe funksionalizimin efektiv të zonave të lira ekonomike (TEDA) si instrument strategjik për zhvillimin ekonomik*, gjatë vitit 2025 janë evidentuar zhvillime konkrete që përfaqësojnë një rikthim të fokusit strategjik tek këto zona. TEDA-t synojnë të rrisin tërheqjen e investimeve dhe vendosjen e aktiviteteve prodhuese, trajnuese dhe teknologjike, veçanërisht në sektorët e përpunimit, TIK dhe digjitalizimit, si dhe për replikimin e këtij modeli në bashki dhe rajone të tjera mbi bazën e planeve konkrete të zhvillimit ekonomik lokal.

Në fillim të vitit 2025, u firmos marrëveshja për TEDA Tiranë (Kashar) me kompaninë izraelite “H.A.PI Advanced Technologies LTD”, duke mundësuar investime në teknologji dhe inovacion. Zona mbulon 35 hektarë dhe synon të tërheqë industri të avancuara si ajo automobilistike, teknologjia e informacionit dhe komunikimit, elektronikë, farmaceutikë dhe agropërpunim.

Në fillim të vitit 2025 është miratuar zyrtarisht hapja e Parkut Teknologjik dhe Shkencor “Durana Tech Park”, përmes vendimit nr. 13, datë 9.1.2025.²³ Më tej, me Vendimin nr. 73,²⁴ datë 29.1.2025, është miratuar marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe

²³ Miratimi i hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor ‘Durana Tech Park’ <https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2025/3/3ed8ac05-61e8-40aa-b3d8-7ebb71faadb6>

²⁴ VKM 73 dt. 29.01.2025 “Për miratimin e planit të zhvillimit të detajuar dhe draftmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe zhvilluesit, Korporata e Investimeve Shqiptare, “për angazhimet e ndërsjella për ndërtimin, administrimin, menaxhimin, funksionimin, operimin dhe monitorimin e parkut teknologjik dhe shkencor ‘DURANA TECH PARK’ <https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2025/17/78e21263-d0e9-433d-8d22-57b4a69816f2>

Inovacionit dhe Korporatës së Investimeve Shqiptare, për ndërtimin, administrimin dhe funksionimin e parkut. Me Vendimin nr. 260, datë 7.5.2025, është shpallur zyrtarisht Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Xhafzotaj, Shijak, duke njohur zyrtarisht edhe zhvilluesin e saj. Këto zhvillime përbëjnë hapat fillestare drejt krijimit të një zone të specializuar për teknologji dhe inovacion, me potencial për tërheqje investimesh dhe rritjen e kapaciteteve vendase në fusha strategjike.

Përtej zhvillimeve të mësipërme, aktualisht, janë 114 rekomandime ende të paplotësuara dhe disa nga rekomandimet ende të papërbushura, por që konsiderohen të rëndësishme për t'u zbatuar, janë:

- » Hartimi dhe miratimi i një Strategjie kundër ekonomisë informale. Dokumenti duhet të shoqërohet me një plan veprimi të detajuar, që përfshin analiza dhe qasje sektoriale, afate të qarta kohore dhe institucione përgjegjëse të mirëpërcaktuar. Gjithashtu, strategjia duhet të konsultohet dhe koordinohet me përfaqësuesit e biznesit për të siguruar efektivitetin e saj.
- » Regjistrimi në ASHK i pasurive të patundshme nën administrimin e bashkive. Duhet të sigurohet publikimi i tyre dhe transparencë mbi statusin e procesit të transferimit dhe regjistrimit, si dhe përdorimi i tyre në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe në funksion të gjenerimit të të ardhurave.
- » Monitorimi dhe rritja e transparencës në koordinimin e investimeve publike (qendrore dhe lokale) në përputhje me strategjitë e sektorëve prioritarë, për të mundësuar optimizimin e investimeve.
- » Forcimi i bashkëpunimit sektorial të biznesit, duke nxitur inovacionin dhe mundësitë për akses në fonde të mundshme nga partnerë për zhvillim. Përmirësimi i angazhimit të shoqatave të biznesit dhe kapaciteteve menaxheriale, duke përmirësuar gjithashtu pjesëmarrjen e sektorit privat në politikat publike.
- » Dhomat e tregtisë dhe shoqatat duhet të ofrojnë gjerësisht programe trajnimit të synuara për drejtuesit e NMVM-ve, duke u fokusuar në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe mentorimin brenda organizatave. Duke theksuar investimet në teknologji dhe automatizim, është thelbësore të prioritetizohen trajnimi dhe zhvillimi i aftësive të stafit për të përmbushur nevojat në rritje të biznesit.
- » Inkurajimi i politikave fiskale në nivel qendror për ato ndërmarrje që kanë një buxhet dhe një numër të caktuar punonjësish të dedikuar për Kërkimin dhe Zhvillimin (K&Zh).
- » Automatizimi i shërbimeve të ofruara në nivel lokal për të përditësuar në kohë reale: (1) informacionin mbi detyrimet që paguhen dhe/ose mbarten nga bizneset, si dhe (2) informacionin mbi bizneset (administratorët). Krijimi i një platforme informuese për shkëmbimin e informacionit online midis bashkive dhe bankave të nivelit të dytë. Unifikimi dhe standardizimi i formateve elektronike të urdhrave të bllokimit gjithashtu do të kontribuonte në përmirësimin e proceseve.

Përshpejtimi i progresit në implementimin e këtyre rekomandimeve do të kërkonte më shumë vëmendje, angazhim aktiv dhe bashkëpunim nga institucionet publike dhe private përgjegjëse.

SHTOJCA I METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Këshilli i Investimeve (KI) operon në mënyrë aktive në Shqipëri prej rreth dhjetë vitesh, duke shërbyer si një lehtësues komunikimi mes sektorit publik dhe atij privat. Objektivi i tij kryesor është të përmirësojë dialogun, të zbusë asimetritë e informacionit dhe të sigurojë pjesëmarrjen aktive të sektorit privat në proceset e reformave ekonomike dhe strukturore. Gjithashtu, duke zvogëluar distancat mes aktorëve të ndryshëm, KI synon të krijojë një atmosferë bashkëpunimi që promovon rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË PARASHIKUARA PËR KËSHILLIN, JANË:

(1) KI të rrisë besueshmërinë e ndërsjelltë mes palëve: Si një platformë e strukturuar dialogu mes sektorit publik e atij privat, KI bazon punën e tij në fakte e synon të gjenerojë besim mes të gjithë aktorëve të përfshirë, duke ndikuar në forcimin e ekonomisë shqiptare.

Tregues kryesor i performancës (KPI): Reagime pozitive nga përfaqësuesit e qeverisë, shoqatat e biznesit, bizneset dhe numri i mbledhjeve të Këshillit.

(2) KI të jetë një mjet efikas reformues: Qeveria dhe komuniteti i biznesit ta shohin e ta përdorin KI si një mjet efikas për reformim të qëndrueshëm ekonomik.

KPI: Numri i rekomandimeve të dhëna të miratuara nga Qeveria; Numri i propozimeve për përmirësimin e klimës së investimeve të pranuar nga autoritetet përkatëse; Numri i ligjeve, rregulloreve, politikave të ndryshuara ose të miratuara bazuar në rekomandimet e Këshillit.

» Veprimtaritë monitoruese në këtë raport janë përqendruar në mbledhjen e të dhënave dhe analizën e informacionit që lidhen me këto dy indikatorë, me qëllim që të:

- » Informojë palët e përfshira dhe t'i përditësojë ato mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëshuara gjatë mbledhjeve të KI, më konkretisht gjatë vitit 2025.
- » Sigurojë palët që ato çfarë janë propozuar janë marrë ose po merren në konsideratë.
- » Mbështesë vendimmarrjen e donatorëve dhe drejtuesve të Sekretariatit përmes ofrimit të informacionit.

QËLLIMI I MONITORIMIT

Raporti i monitorimit evidenton ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KI të miratuara gjatë periudhës 2015-2025, duke marrë parasysh se disa rekomandime të lëshuara në vitet e mëparshme kërkojnë kohë për t'u përbushur, ndërsa rekomandimet e lëshuara gjatë vitit të kaluar kërkojnë kryesisht të paktën 6 muaj ose më shumë që të miratohen dhe përpunohen nga institucionet vendimmarrëse. **Ky raport paraqet një përmbledhje të nismave të ndërmarra dhe raportuara nga institucionet publike përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të KI dhe nuk vlerëson ndikimin e tyre në sektorin privat.** Përbajtja bazohet në të dhëna cilësore dhe sasiore të mbledhura gjatë vitit 2025 përmes aktiviteteve të mëposhtme:

I – AKTIVITETE MONITRUESE NË NDËRVEPRIM ME INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE:

- » Shkëmbimi zyrtar i informacionit përmes korrespondencës me shkrim pas çdo mbledhjeje të KI-së, duke adresuar rekomandimet specifike që priten të zbatohen nga institucionet përkatëse;
- » Monitorim periodik i nivelit të zbatimit të rekomandimeve specifike çdo tremujor. Takimet direkte dhe komunikimi përmes korrespondencës me shkrim, postës elektronike dhe telefonatave të shpeshta kanë qenë në fokus të bashkëpunimit me institucionet që raportuan zyrtarisht aktivitetet e tyre mbi përbushjen ose jo të rekomandimeve përkatëse.¹

II – PUNË HULUMTUESE

Përveç korrespondencës zyrtare, u konsultuan një sërë dokumentash zyrtare me qëllim identifikimin e ndryshimeve përkatëse lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të KI. Më konkretisht, dokumentet e konsultuara përfshinin (1) Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM), (2) Vendime të Ministrave, (3) Ligje, akte nënligjore (ndryshimet e tyre), (4) strategji të miratuara/draftuara, (5) Plane veprimi, (6) Raporte të progresit të BE-së, dhe (7) Raporte ndërkombëtare. Lista e dokumenteve kryesore të konsultuara gjendet në Shtojcën 2.

III – BURIME DYTËSORE INFORMACIONI

Një nga aktivitetet më të shpeshta ka qenë monitorimi i përditshëm i faqeve të internetit, platformave, rrjeteve sociale e medias vizive, si burime informacioni ku promovohen aktivitetet e ndërmarra nga institucionet publike, si dhe platformat e konsultimeve, artikujt në gazeta, njoftimet për shtyp, lajmet, etj. Përveçse një mjet dytësor për verifikimin e

1

Detajuar në Shtojcën 2.

informacionit lidhur me përmbushjen apo jo të rekomandimeve të KI, këto burime shërbejnë gjithashtu si matës i nivelit të transparencës së institucioneve zbatuese dhe nivelit të angazhimit të tyre me sektorin privat. Disa nga faqet e internetit të konsultuara janë renditur në Shtojcën 2.

IV – PËRPUNIMI I TË DHËNAVE

Çdo informacion i marrë nga komunikimi me institucionet, dokumentet justifikuese apo publikimet online, regjistrohen në bazën e të dhënave të rekomandimeve. Baza e të dhënave përditësohet me informacionet e reja që diskutohen mes ekspertëve të Sekretariatit për dakordësim mbi statusin e rekomandimeve përkatëse. Çdo gjashtëmuaj, gjenerohet një raport faktik mbi ecurinë e rekomandimeve.

V – RAPORTIMI

Gjetjet nga aktivitetet monitoruese dhe përditësimi i progresit iu raportohet anëtarëve të KI² dhe publikohen çdo gjashtëmuaj në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të KI.

PARIMET E MONITORIMIT³

Parimet që udhëheqin aktivitetet monitoruese janë:

- » Bashkëpunim i ndërsjellë me të gjithë aktorët, partnerët dhe institucionet qeveritare.
- » Transparencë e të dhënave dhe informacionit për anëtarët e KI, donatorët dhe palët e tjera të përfshira.
- » Konsultimi i të paktën dy burimeve të pavarura për të saktësuar informacionin e marrë.
- » Shkëmbim opinionesh, informacionesh, dialog mbi përditësimet dhe dakordësim i gjithë stafit të Sekretariatit mbi ecurinë e përmbushjes së rekomandimeve (si nga ana cilësore ashtu edhe sasiore).
- » Argumentimi i rezultateve bazuar në të dhëna të faktuara në rrugë zyrtare.

2 Përmes e-mail dhe/ose prezantimit në mbledhje gjatë vitit.

3 Referencë "Manuali i Monitorimit" i KI

SHTOJCA 2 LISTA E DOKUMENTAVE TË KONSULTUARA

- » Progres Raporti i BE-së – “Komunikimi i vitit 2025 mbi politikën e zgjerimit të BE-së”, Nëntor 2025
- » Raport Monitorimi 2021-2024 i “Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe plani i veprimit”
- » Vendimi Zbatues i Komisionit për miratimin e disbursimit të dytë të fondeve për Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor -Vlerësimi i Kushteve për Pagesë – Shqipëria
- » VKM nr. 824, datë 26.12.2024 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Specializimit Inteligent (S3) 2025–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”
- » VKM nr. 62/2025, datë 18.9.2025 “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave”
- » VKM nr. 91, datë 12.2.2025 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2026–2028”
- » VKM nr. 46, datë 22.1.2025 “Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2025- 2027
- » VKM nr. 666, datë 12.11.2025 “Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2026 - 2028, të rishikuar”
- » VKM nr. 733, datë 3.12.2025 “Për miratimin e planit të veprimit të Agjendës Digjitale

për Arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale”

- » Urdhër i Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 180, datë 30.12.2025 “Programi për nxitjen dhe lehtësimin e eksporteve 2026–2030”
- » Urdhër i Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 183, datë 30.12.2025 “Për miratimin e planit të veprimit për promovimin e eksporteve dhe ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve, përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë përmes korridoreve të gjelbra”
- » “Strategjia për sigurinë kibernetike 2025-2030 dhe plani i veprimit 2025–2027” miratuar me VKM nr. 606, datë 23.10.2025
- » “Strategjia e Turizmit 2025–2030 dhe të planit të veprimit” aprovuar me VKM nr. 466, datë 31.7.2025
- » VKM nr. 463 dt. 31.07.2025 “Miratimi i skemës së veçantë të garancisë shtetërore të huasë për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë”
- » Ligji nr. 50/2025 “Për ratifikimin e vendimit nr. 2/2024, të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore për Tregtinë Elektronike”, aprovuar më 3.7.2025 që ratifikon vendimin e CEFTA-s për lehtësimin e tregtisë elektronike.
- » Vendim nr. 260, datë 7.5.2025 “Për shpalljen e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit ekonomik dhe zhvilluesit të zonës me vendndodhje në Xhafzotaj, Shijak”
- » VKM nr. 99, datë 12.2.2025 “Për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit dhe detyrat e komitetit për të dhënat statistikore në turizëm”
- » Vendim nr. 77, datë 5.2.2025 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore” - data-baza e treguesve të statistikave zyrtare
- » VKM nr. 73 datë 29.01.2025 “Për miratimin e planit të zhvillimit të detajuar dhe draft-marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe zhvilluesit, Korporata e Investimeve Shqiptare, “për angazhimet e ndërsjella për ndërtimin, administrimin, menaxhimin, funksionimin, operimin dhe monitorimin e parkut teknologjik dhe shkencor DURANA TECH PARK”
- » Projektligji “Për Identifikimin Elektronik, Shërbimet e Besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital”, datë 3 qershor 2025
- » Udhërrëfyesi i digjitalizimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës 2025–2028
- » Vendimi nr. 178 datë 30.12.2025 “Për miratimin e planit të veprimit për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në indeksin e OECD për politikën e NMVM-ve”
- » Ligji nr. 74/2025, datë 4.12.2025 “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”
- » Urdhër i Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 182, datë 30.12.2025 “Për miratimin e planit të veprimit për përmirësimin e kuadrit për rritjen e atraktivitetit të investimeve, veçanërisht të investimeve të huaja direkte, si dhe të mjedisit të biznesit, nëpërmjet derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve për biznesin”

LISTA E INSTITUCIONEVE TË KONTAKTUARA ZYRTARISHT:

- » Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
- » Banka e Shqipërisë
- » Shoqata Shqiptare e Bankave
- » Agjencia Shtetërore e Kadastrës
- » Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

BURIMET SEKONDARE TË KONSULTUARA PERIODIKISHT:

- » <https://www.konsultimipublik.gov.al/>
- » <https://kryeministria.al/>
- » www.akademi.al
- » <https://qbz.gov.al/> <http://aida.gov.al/sq/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://www.bankofalbania.org/>
- » <https://aab.al/>
- » [https:// www.parlament.al/Projektligje/IndexList](https://www.parlament.al/Projektligje/IndexList)
- » <https://invest-in-albania.org/>
- » <https://aida-smefinance.gov.al/>
- » www.exportalbania.al
- » [https:// www.ashk.gov.al/](https://www.ashk.gov.al/) (dhe FB, Instagram)
- » [http:// www.azht.gov.al/](http://www.azht.gov.al/) (dhe FB, Instagram)
- » [https:// www.financa.gov.al/](https://www.financa.gov.al/) (dhe FB, Instagram)
- » [https:// www.infrastruktura.gov.al/](https://www.infrastruktura.gov.al/) (dhe FB, Instagram)
- » <https://arsimi.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://bujqesia.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://shendetesia.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://turizmi.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » Udhërrëfyesi i Digjitalizimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës 2025–2028 – ASHK



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

RECOMMENDATIONS MONITORING REPORT 2025

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Staf

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Pregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Rruga "Ibrahim Rugova", Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT



European Bank
for Reconstruction and Development



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).